# VENDIM

## Nr. 176, date 3.5.2002

## PER NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN NR. 450, DATE 1.7.1998 TE KESHILLIT TE MINISTRA VE "PER ADMINISTRIMIN E QYTETIT ANTIK TE BUTRINTIT"

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 3 te ligjit nr. 7867, date 12.10.1994 "Per mbrojtjen e pasurive kulturore, te luajtshme dhe te paluajtshme", me propozimin e Ministrit te Kultures, Rinise dhe Sporteve, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Ne piken 4 te vendimit nr. 450, date 1.7.1998 te Keshillit te Ministrave "Per administrimin e qytetit antik te Butrintit", perberja e anetareve te Bordit, te administrimit dhe bashkerendimit te qytetit antik te Butrintit ndryshon si me poshte vijon:

| | |
|---|---|
| -Ministri i Kultures, Rinise dhe Sporteve | Kryetar |
| -Zevendesministri i Rregullimit te Territorit dhe Turizmit | anetar |
| -Drejtori i Institutit te Monumenteve te Kultures | anetar |
| -Drejtori i Institutit te Arkeologjise | anetar |
| -Perfaqesues i Ministrise se Mjedisit | |
| -Drejtori i Trashegimise Kulturore ne Ministrine e Kultures Rinise dhe Sporteve | anetar |
| -Perfaqesues i Ministrise se Puneve te Jashtme qe merret me UNESKO-n | anetar |

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit te Fletoren Zyrtare.

KR YEMINISTRI
Pandeli Majko